



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

Draft
PROJEKT VENDIM
“MBI MBETJET BIO”

Draft 1
Version 4

29 Tetor 2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIMI
Nr. _____, datë _____

“MBI MBETJET BIO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 28 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i masave, kriterëve dhe rregullave për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill dhe i afateve për arritjen e tyre.
2. Për arritjen e këtij qëllimi, ky vendim nxit:
 - a. Grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime kompostimi dhe digjestimi;
 - b. Trajtimin e mbetjeve bio në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit;
 - c. Përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio që janë të sigurta për mjedisin.

II. OBJEKTI

3. Ky vendim zbatohet për mbetjet bio.
4. Incinerimi i mbetjeve bio dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve bio me kapacitet mbi 50 ton/në ditë përjashtohen nga objekti i këtij vendimi.

III. PËRKUFIZIME

5. Termat e përkufizuar në nenin 3, të Ligjit nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a. “Njësitë e qeverisjes vendore” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;
 - b. “Ministri” është Ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
 - c. “Ministria” është Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
 - d. “Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM)” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

IV. AFATET PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE BIO

6. Afatet për ngritjen e sistemit të grumbullimit të mbetjeve bio, të paktën me frekuenca javore, janë njësoj si në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”. Bashkitë e kategorisë së parë, sipas përcaktimit në nenin 3 të ligjit nr. 10258, datë 25.3.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Pogradeci, Korça, Lezha, Lushnja, Kukësi, Peshkopia, Laçi, Kamza dhe Kavaja) duhet të ngrenë këtë sistem brenda 30 Qershorit 2016.
7. Njësitë e tjera të qeverisjes vendore, përveç atyre të kategorisë së parë, duhet të marrin masa të përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio brenda 31 Dhjetorit 2018.
8. Njësitë e qeverisjes vendore, përveç atyre të kategorisë së parë, në planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve dhe në përputhje me nevojat vendore dhe mundësitë aktuale mund të realizojnë grumbullimin e mbetjeve bio nga shtëpitë me frekuenca më të gjata se javore ose të zbatojnë sisteme të tjera të ndryshëm nga grumbullimi i mbetjeve bio, të tilla si kompostimi i mbetjeve në oborret e shtëpive.

V. OBJEKTIVAT PËR PAKËSIMIN E MBETJEVE BIO QË SHKOJNË NË LENDFILL

9. Objektivat që duhen arritur nga njësitë e qeverisjes vendore për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill duhet të arrijnë minimalisht në 50% të peshës së tyre:
 - a. Jo më vonë se 5 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, sasia e mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill duhet të bjerë në 75% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në 2010;
 - b. Jo më vonë se 10 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi sasia e mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill duhet të bjerë në 50% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në 2010;
 - c. Jo më vonë se 15 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi sasia e mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill duhet të bjerë në 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuar në 2010.
 - d. Pakësimi i peshës së mbetjeve bio si rezultat i kompostimit të mbetjeve të përziëra vetëm për qëllime paratrajtimi, konsiderohet si kontribut në sasinë totale të mbetjeve të kompostuara, meqënëse pakëson sasinë e mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill dhe duhet të llogaritet si pjesë e objektivave të arritur të përcaktuar në këtë paragraf.
10. Objektivat specifike për ripërdorimin dhe riciklimin sipas peshës së mbetjeve duhet të arrihen jo më vonë se 15 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve bio duhet të arrijnë të paktën 35% të peshës totale të mbetjeve bio të prodhuara në 2010.
11. Përdorimi i materialeve të prodhuara nga mbetjet bio për restaurimin e lëndfilleve dhe/ose për përmirësimin e tokës duhet të llogaritet si pjesë e objektivave të arritur për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve bio.

12. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka detyrimin të arrijë objektivat e përcaktuara në paragrafin 10.

VI. DETYRAT E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE BIO

13. Masat, kriteret dhe rregullat që duhen zbatuar për sigurimin e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve bio përcaktohen në Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të përgatitur në përputhje me Udhëzimin e Ministrit “Për miratimin e manualit ”Për planifikimin vendor të menaxhimit të mbetjeve””.
14. Masat e referuara në paragrafin 13 duhet të merren në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në Aneksin I.
15. Shtëpitë në zonat rurale duhet të kompostojnë në shtëpi, në nivel lagje ose komune duke zbatuar metodat optimale që respektojnë traditat lokale.
16. Në rastet e zonave me shtëpi private të shpërndara, njësia e qeverisjes vendore duhet të sigurojë kontenerë individualë për të lehtësuar kompostimin dhe/ose digjestimin e duhur të mbetjeve bio, sipas rastit.
17. Njësia e qeverisjes lokale në zonat urbane duhet të nxisin, kur është e përshtatshme, kompostimin në shtëpi ose në nivel lagje, duke zbatuar metodat optimale që respektojnë traditat lokale.
18. Njësia e qeverisjes vendore në zonat rurale harton dispozita detyruese për kompostimin në shtëpi ose në nivel lagje. Masa dhe metoda të tjera për të arritur objektivat brenda afateve të përcaktuara, duhet të parashikohen në çdo Plan Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit “Për miratimin e manualit ”Për planifikimin vendor të menaxhimit të mbetjeve”” referuar në paragrafin 13.
19. Ministri miraton me Udhëzim standardet teknike minimale për kompostimin e mbetjeve bio.

VII. BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETEVE

20. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë midis tyre për të nxitur:
 - a) optimizimin e zonave të menaxhimit të mbetjeve;
 - b) optimizimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve bio;
 - c) ngritjen e skemës së ndarjes së mbetjeve bio.
21. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të impianteve në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” për arritjen e objektivave të parashikuara në paragrafin 20. Ky bashkëpunim do të mundësojë grumbullimin optimal të mbetjeve bio, ripërdorimin dhe riciklimin ose asgjësimin në një nga impiantet më të afërt, me teknologjitë dhe metodat më të përshtatshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik.

VIII. RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

22. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon regjistrin për regjistrimin e peshës së mbetjeve të grumbulluara prej tyre në total, të sasisë së dërguar për kompostim, si dhe të të dhënave të siguruara nga të gjithë operatorët e mbetjeve për territorin nën

- juridiksionin e tyre. Të dhënat e grumbulluara për bashkitë dërgohen në AKM brenda 28 Shkurtit të çdo viti.
23. Çdo njësi e qeverisjes vendore raporton të dhëna mbi grumbullimin e mbetjeve bio dhe objektivat e kompostimit në AKM brenda 31 Janarit të çdo viti.
 24. AKM përpunon të dhënat mbi peshën totale të mbetjeve bio të grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe objektivat e arritur në nivel kombëtar dhe i regjistron ato në regjistrin e krijuar për këtë qëllim. Këto të dhëna transmetohen në Ministri brenda 28 Shkurtit të çdo viti.
 25. AKM i përfshin rezultatet e ritmeve të grumbullimit të mbetjeve bio në raportin vjetor për gjendjen e mjedisit.
 26. Ministria harton raportin mbi zbatimin e këtij vendimi, si pjesë integrale të raportit për zbatimin e ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të parashikuar në nenin 66, brenda 30 Shtatorit 20XX dhe më pas çdo tre vjet.
 27. Ministri me Urdhër miraton formatin që duhet përdorur për hartimin e raportit, të parashikuar në paragrafin 26, së bashku me informacionin që duhet përfshirë në të. Raporti duhet të përmbushë kërkesat minimale të përcaktuara në Aneksin II.
 28. AKM, agjencitë rajonale të mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera i sigurojnë Ministrisë informacionin përkatës për përgatitjen e raportit.
 29. Raporti publikohet në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë dhe bëhet i disponueshëm për publikun.
 30. AKM krijon, menaxhon dhe përditëson sistemin e bazës së të dhënave për grumbullimin e mbetjeve bio.

IX. SANKSIONET

31. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

X. ANEKSET

32. Anekset bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij.

XI. HYRJA NË FUQI

33. Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

SALI BERISHA

ANEKSI I
Kërkesat minimale për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio
(referuar në Seksionin VI të këtij vendimi)

Kërkesat minimale të mëposhtme që referohen në paragrafin 14:

1. Përcaktimi i kufijve administrative të zonave të shërbimit për mbetjet dhe të përgjesisë për këto zona, duke përcaktuar qartë, se kush është përgjegjës për dispozitat e shërbimit të mbetjeve bio;
2. Përcaktimi i zonave kufi midis njësive të qeverisjes vendore fqinje, ku krijohen paqartësi dhe konflikte për shkak të atyre Njësive të Qeverisjes Vendore që nuk ofrojnë asnjë shërbim për mbetjet;
3. Informacion mbi prodhuesit e mbetjeve bio duke siguruar të dhëna të vlefshme se cila njësi e qeverisjes vendore do t'i shërbejë atyre;
4. Vlerësimi i volumit dhe përcaktimi i origjinës së mbetjeve që do të menaxhohen (informacioni përfshin të dhënat aktuale dhe trendet e mëparshme – për një periudhë 5-8 vjet – në lidhje me popullsinë brenda zonës së tyre të përgjegjesisë, karakteristikat e tyre, numrin dhe madhësinë mesatare të shtëpive, llojin dhe madhësinë e fermave; numrin e kopshteve dhe parqeve publike, edukimin, ndërtesat sociale ose kulturore, të cilat mund të prodhojnë mbetje nga kopshtet ose mbetje të tjera bio.
5. Informacioni shtesë mund të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të të dhënave mbi shtëpitë në qytet dhe fshat, duke specifikuar llojin e rezidencës (të përhershme ose të përkohshme), si dhe informacionin që mbulon rezidentët që jetojnë në zonat informale pranë kufijve të qytetit;
6. Përcaktimi i skemës së grumbullimit dhe transportit të mbetjeve bio në lidhje me aktivitetet lokale, në kuptim të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve; kjo mund të përfshijë ose të shoqërohet shpesh me aktivitete të tjera të tilla si: ndarja e mbetjeve, përpunimi, transferimi, etj.
7. Analiza dhe vlerësimi i situatës fillestare dhe/ose e vendimit për përmirësimin e skemës ekzistuese ose planit për të filluar një shërbim të ri:
 - a) Pikat e grumbullimit të mbetjeve do të kenë të paktën një kontenier për mbetjet bio;
 - b) Shpeshësia e grumbullimit të mbetjeve bio mundësisht të koordinohet me atë të rrymave të tjera të mbetjeve;
 - c) Kamionët dhe kontenierët e mbetjeve;
 - d) Përmirësimi i rrugëve të kamionëve;
 - e) Përzgjedhja e llojit të përshtatshëm të kontenierit.

ANEKSI II: Kërkesat minimale të raportimit (referuar në Seksionin VIII të këtij Vendimi)

Kërkesat minimale dhe informacioni i mëposhtëm duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së raportit referuar në paragrafin 28:

1. Në nivel kombëtar

- a) Përshkrimi i metodave të grumbullimit të mbetjeve bio;
- b) Përshkrimi i metodave të regjistrimit të sasisë së mbetjeve bio;
- c) Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga njësitë e qeverisjes vendore, referuar paragrafit 2 të këtij Aneksi;
- d) Vlerësimi i përgjithshëm mbi objektivat e arritur për mbetjet bio.

2. Në nivel të njësive të qeverisjes vendore

- a) Të dhënat e mbetjeve të gjeneruara për mbetjet bio në kuadër të raportimit;
 - i. Pesha e përgjithshme për mbetjet bio të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
 - ii. Pesha e përgjithshme për mbetjet sipas llojit të materialeve përbërëse.
- b) Si janë grumbulluar mbetjet;
- c) Kush i ka grumbulluar mbetjet;
- d) Sa shpesh janë grumbulluar mbetjet;
- e) Identifikimi i kontraktorëve të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve bio;
- f) Destinacioni i mbetjeve bio;
- g) Sasia e mbetjeve bio të trajtuara/përpunuara dhe lidhja me sasinë e grumbulluar.